

AMU / DMH

E drejta për shërbime mjeksore për personat pa qëndrim legal



Çfarë është AMU / DMH ?

Ndihma Mjeksore Urgjente (AMU në frëngjisht dhe DMH në gjuhën flamane) është një ndihmë e parashikuar prej Shtetit belg për personat pa qëndrim legal. Ajo ka për qëllim tu mundësojë personave pa qëndrim legal të marrin shërbime mjeksore.



A mundeni ju të keni këtë ndihmë ?

Ju mund ta keni këtë ndihmë, në rast se juve jini :

- › pa të ardhura = **Juve nuk mundeni të paguani shërbimet mjeksore ose shuma për tu paguar është shumë e madhe, që juve të mund të jetoni akoma denjesisht.**
- › pa qëndrim legal : **Juve duhet të shpjegoni situatën tuaj dhe të tregoni dokumentat që mund të ndihmojnë për të kuptuar situatën tuaj të qëndrimit (si për shëmbull një vizë të cilës i ka mbaruar afati, një dokument qëndrimi i cili nuk është më i vlefshëm, një urdhër për tu larguar nga territori...).**



Ku mundeni ju ta kërkonte këtë ndihmë ?

Juve duhet ta kërkonte këtë Ndihmë Mjeksore Urgjente në CPAS(OCMW në gjuhën flamane) të komunës ku juve qëndroni në mënyrë të zakonshme (= ose ku juve banoni).

- ▶ **Për më shumë informacion, shikoni dokumentin tonë : « CPAS / OCMW. Si te bëhet një kërkesë për Ndihmë Mjeksore Urgjente »**



AMU, është vetëm për shërbimet mjeksore të cilat janë shumë urgjente ?

Jo, thuhet se kjo ndihmë është 'urgjente' por në realitet kjo kjo ndihmë mjeksore është shumë më e gjerë se sa shërbimi « 112 » ose shërbimet e urgjencës të spitaleve.

Çdo lloj shërbimesh mund të merret në ngarkim : për shëmbull, një konsultim te një doktor ose një dentist, ilaçe, marrje gjaku, një operacion... Shërbimi mund të merret në spital ose jashtë spitalit.

- ▶ Ndihma mjeksore mund të jetë gjithashtu preventive (= ndihmë për të parandaluar problemet mjeksore). Disa shëmbuj : vaksina, ndjekja e shtatzanisë e një gruaje shtatzënë...



Kush vendos në se shërbimet mund të sigurohen prej AMU ?

Eshtë mjeku i cili vendos në se shërbimet mund të sigurohen prej Ndihmës Mjeksore Urgjente. Ai plotëson një vërtetim të 'Ndihmës Mjeksore Urgjente'. Ky vërtetim është i nevojshëm me qëllim që shërbimet mjeksore të paguhen dhe shërben si provë në rast kontrolli nga ana e Shtetit. Eshtë mjeku ose CPAS-i që ruajnë vërtetimin.



Kush i paguan shërbimet mjeksore ?

Eshtë CPAS-i ose një organizëm i cili quhet CAAMI (në frëngjisht) ose HZIV (në gjuhën flamane). Shteti belg rimbursos të gjitha shërbimet të cilat gjenden në listën e cila quhet nomenklaturë INAMI (RIZIV në gjuhën flamane). Ndonjëherë, shërbimet ose ilaçet nuk gjenden në listën e INAMI (si përshëmbull disa qetsues dhimbjesh, protezat e dhëmbëve, këpucët ortopedike, syzet...).

- ▶ Ndonjëherë është e ndërlikuar për të ditur në se një shërbim gjendet në listën e INAMI sepse kjo mund të varet nga rëndësia e probemit mjeksor ose moshë e pacientit. Në rast dyshimi, pyesni mjekun tuaj ose farmacistin tuaj !

Në rast se shërbimet nuk gjenden në këtë listë, CPAS-i mund të paguajë por nuk do të rimbursohet prej Shtetit belg.



A mundet që një kërkesë AMU të ketë pasoja negative ?

Jo, punonjësit socialë të CPAS-it i nënshtrohen sekretit profesional dhe informacionet që gjenden në vërtetimet mjeksore janë konfidenciale. As policia, as Zyra e të huajve nuk mund të vihen në dijeni për këtë ndihmë mjeksore. Prej 25 vjetësh që Medimmigrant ekziston, nuk ka patur kurrë ndonjë ankesë lidhur me këtë subjekt.

Ky dokument u realizuar prej asbl Medimmigrant. Për më shumë informacion lidhur me këtë subjekt, juve mundeni të :



konsultoni sitin tone internet > www.medimmigrant.be



të na drejtoni pyetjet tuaja me anë të e-mailit > info@medimmigrant.be



të na merrni në telefon gjatë orareve tona të pritjeve telefonike >

02/274 14 33 ose **0800/14.960** (n° falas për personat me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura)

> hënë **nga ora 10 deri në orën 13** | martë **nga ora 14 deri në orën 18** | enjte **nga ora 10 deri në orën 13** | premte **nga ora 10 deri në orën 13**